



KOMUNA E KLINËS 2017: PROBLEMET KRYESORE DHE TRENDET BUXHETORE

Hyrje

Pas shtatë viteve të qeverisjes së Komunës së Klinës nga ana e Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), zgjedhjet lokale të vitit 2007 nxorën Partinë Demokratike të Kosovës (PDK) si forcën më të madhe politike në këtë komunë. Në zgjedhjet e para për kryetar komune fitues doli Sokol Bashota nga PDK. Sokol Bashota u rizgjodh kryetar komune edhe pas zgjedhjeve lokale të mbajtura në vitin 2009 dhe 2013.

Në zgjedhjet e kaluara komunale, kandidatët për kryetarë kanë dhënë premtime të cilat nuk bien nën kompetencat vetanake të komunave. Megjithatë, hulumtimet tregojnë se qytetarët e Kosovës kanë njohuri të mjaftueshme mbi ndarjen e kompetencave në mes të pushtetit qendror dhe lokal.¹ Mbi 90% e qytetarëve të Klinës besojnë që pushteti lokal mund t'i zgjidhë të gjitha apo disa nga probleme me të cilat ballafaqohen ata në komunën e tyre.² Ndërsa sa i përket shkallës së kënaqshmërisë së qytetarëve të Klinës me pushtetin lokal (Kryetarin e Komunës, Kuvendin Komunal dhe Administratën Komunale), del se ka rënie të theksuar të kënaqshmërisë nga 17.943 pikë në vitin 2012 në -1.33 në vitin 2015.³

Në hulumtimin e zhvilluar nga Instituti GAP në fund të vitit 2013, problemet kryesore që ka pasur në atë kohë kjo komunë kanë qenë mungesa e ujit të pijes, gjendja e keqe e objekteve, pluhuri nga gurthyesit, mungesa e sistemit të kanalizimit, mungesa e çerdheve,

¹ Instituti GAP, Adresimi i Përgjegjësisë: Njohuritë e qytetarëve me kompetencat e komunave. Maj 2017. Burimi:

² UNDP, Mozaiku i Kosovës 2015, faqe 37. Burimi: <http://bit.ly/1d30foS>.

³ Ibid. faqe 39

mungesa e shtëpisë së kulturës dhe bibliotekës dhe mungesa e nënkalimeve dhe urave.⁴

Problemet aktuale të Komunës së Klinës

Mungesa e rrjetit të ujësjellësit

Komuna e Klinës, me ndihmën e Komisionit Evropian, ka ndërtuar dhe hapur fabrikën e re për gjenerimin e ujit të pijes, në vendin "Drini i Bardh". Sipas një studimi të bërë nga UNDP, qytetarët e Komunës së Klinës furnizimin e dobët me ujë e kanë cilësuar si problem kryesor.⁵ Niveli i kënaqshmërisë së qytetarëve me furnizimin me ujë sipas këtij hulumtimi është 41%.⁶ Nga 43 lokalitete sa ka gjithsej Klina, akoma në 31 lokalitete mungon rrjeti i ujësjellësit si në Budisalc, Stupë, Rudicë, Krushevë, Leskoc, Jagodë, Zabergjë, Grebnik, Nagllavë, Gllarevë, Dusheviq, Dugajevë, Deis dhe në Berkovë. Përveç këtyre lokaliteteve një pjesë e konsiderueshme e periferisë së qytetit të Klinës nuk ka rrjet të ujësjellësit.

Pluhuri nga gurthyesit. Bashkëbiseduesit në këtë komunë kanë shfaqur shqetësim nga ndotja e ajrit dhe shkalla e lartë e pluhurit e cila vjen kryesisht nga prezenca e gurthyesëve. Gurthyesit janë aktiv në fshatin Gllarevë, Gremnik, Dollc, Perqeve, Volljak dhe Sferkë. Te dhënat e UNDP-së tregojnë se 33% e banorëve të Komunës së Klinës janë të kënaqur me mbrojtjen mjedisore dhe ruajtjen e natyrës dhe specieve në këtë komunë.⁷

Mungesa e çerdheve. Komuna e Klinës ka vetëm një çerdhe publike. Kjo çerdhe është rindërtuar dhe ka rritur kapacitetet për pranim të fëmijëve, me ndihmën e organizatës Save the Children në Kosovë. Mirëpo, nevoja për çerdhe ndihet në disa zona të kësaj komune. Kësisoj, çerdhe është kërkuar nga banorët e lagjes "Arbëria", lagjja "Tikveshi", fshati Çabiç, fshati Caravik, fshati Siqevë, fshati Ujëmirë, fshati Volljakë.

Mungesa e parkingjeve. Komuna e Klinës nuk ka vend-parkingje publike. Kënaqshmëria e qytetarëve të Klinës sa i përket shenjzimit

⁴ Instituti GAP, Komuna e Klinës: problemet kryesore dhe trendët buxhetore, Burimi: <http://bit.ly/2rUMhwi>

⁵ Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim - UNDP, Mozaiku i Kosovës 2015, faqe 52. (Hapur më 20 qershor 2017)

⁶ Ibid. faqe 88

⁷ Ibid. faqe 77

të pikave për parking publik, sipas raportit të UNDP-së, është 10.2 %, nivel ky shumë i ulët në krahasim me komunat e tjera.⁸

Derdhja e kanalizimit në shtratin e lumit “Klina” dhe “Lumëbardhi”. Të gjitha kanalizimet fekale dhe atmosferike në Komunën e Klinës derdhen në shtratin e lumit “Lumëbardh” dhe lumit “Klina”. Shtrati i këtyre lumenjve shfrytëzohet edhe për hedhjen e mbeturinave.

Fushave që komuna duhet t’u kushtojë vëmendje

Ndërtimi i hapësirave sportive. Komuna e Klinës në të gjitha zonat ka mungesa të hapësirave rekreative sportive. Komuna do të duhet t’i kushtojë vëmendje kësaj sferë dhe në të ardhmen të parashoh krijimin e kushteve për rekreacion dhe sport se paku në zonat kryesore të qytetit.

Promovimi i gjetjeve arkeologjike në zonën e Dresnikut. Ngjashëm si parku arkeologjik “Ulpiana” në Prishtinë do të mund të shndërrohet edhe zona e Dresnikut të Klinës ku janë zbuluar artefakte të gjera. Kjo do të mund të shndërronte Klinën në një destinacion turistik dhe atraktiv. Klina duhet të promovojë këtë zonë dhe njëherazi duhet të investojë në ekspedita tjera kërkimore në afërsi të gjetjeve arkeologjike në Dresnik.

Trendet buxhetore në Komunën e Klinës (2017)

Komuna e Klinës, në vitin 2017, ka planifikuar 8.6 milion euro buxhet.⁹ Në këtë buxhet do të barten nga viti 2016 edhe 328 mijë euro të tjera nga të hyrat vetanake të pashpenzuara.¹⁰ Krahasuar me buxhetin e planifikuar të vitit 2013*¹¹, që ishte vit i zgjedhjeve lokale, Komuna e Klinës ka pasur një rritje prej 1.1 milionë euro të buxhetit. Kjo rritje në masë të madhe buron nga rritja e granteve qeveritare.

⁸ Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim - UNDP, Mozaiku i Kosovës 2015, faqe 52. (Hapur më 20 qershor 2017)


⁹ Shih për më shumë platformën buxhetore të Institutit GAP në <http://bit.ly/2tsvQcD> dhe Ligjin Nr. 05/L-125 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2017.

¹⁰ Ministria e Financave. Raporti Financiar 2016. Burimi: <http://bit.ly/2eFtgKj>, faqe 63 (hapur më 6 shtator 2017).

* Në këtë vit mjetet e bartura nga të hyrat e pashpenzuara ishin rreth 165 mijë euro. Shih Raportin vjetor financiar 2012. Ministria e Financave. Burimi: <http://bit.ly/2wkArJf>, faqe 60 (hapur më 6 shtator 2017).

¹¹ Shih Ligjin Nr. 04/L-165 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2013.

Figura nr.1: Buxheti i Komunës së Klinës 2017




Rritja e buxhetit më 2017 është bërë kryesisht në kategorinë e pagave dhe mallrave dhe shërbimeve. Ndërsa, ka pasur ulje në kategorinë e investimeve kapitale dhe subvencioneve dhe transfereve. Nga 4.4 milionë euro buxhet për paga më 2013, më 2017 kjo kategori ka pasur rritje të buxhetit në 5.7 milionë euro. Ndikim të madh në rritjen e buxhetit për paga kishte vendimi i Qeverisë së Kosovës i vitit 2014 për rritjen e pagave në sektorin publik për 25%.¹² Po ashtu, angazhimi i 13 punonjësve të rinj¹³ në periudhën 2013-2016 ka bërë që shpenzimet për paga të rrisin pjesëmarrjen e tyre në buxhetin vjetor të komunës. Kurse, kategoria e mallrave dhe shërbimeve edhe pse në 2017 ka buxhet më të lartë së në 2013 për mbi 50 mijë euro (660 mijë euro) pjesëmarrja e saj në buxhetin total mbetet në përqindje të njëjtë si në 2013 (8%). Ndërsa në kategorinë e investimeve kapitale ka ulje të buxhetit (2017) për 4 pikë përqindje në krahasim më 2013.

¹² Zyra e Kryeministrit, Vendimet e mbledhjes së 172-të të qeverisë. Burimi: <http://bit.ly/2j9tKgl> (hapur më 6 shtator 2017)


¹³ Ministria e Financave. Raporti Financiar 2016. Burimi: <http://bit.ly/2eFtgKj> (hapur më 6 shtator 2017).

Figura nr.2: Trendet buxhetore të Klinës më 2013 dhe 2017



Të hyrat vetanake të Komunës së Klinës kanë pasur ngritje dhe rënie të lehta përgjatë katër viteve të fundit. Mirëpo, Komuna e Klinës që nga 2010 ka mbajtur një mesatare të qëndrueshme të hyrash komunale. Gjatë vitit 2016 janë realizuar si të hyra vetanake 841 mijë euro, rritje kjo e lehtë në krahasim me vitin 2015 kur janë shënuar rreth 790 mijë euro të hyra.¹⁴ Tatimi në pronë mbetet kategoria që kontribuon më së shumti në të hyrat komunale (34%). Përderisa kategoritë tjera, ku përjashtim bën edhe ajo e gjobave nga gjykatat, kanë pjesëmarrje më të vogël.¹⁵


Figura nr.3: Të hyrat komunale të Klinës, 2013-2016



Burimi: Zyra e Auditorit të përgjithshëm

¹⁴ Zyra e Auditorit të Përgjithshëm. Raporti për Komunën e Istogut 2016. Burimi: <http://bit.ly/2eRiiFh> (hapur më 6 shtator 2017).

¹⁵ Raporti i të hyrave dhe shpenzimeve të realizuara buxhetore për periudhën janar – dhjetor 2016 për Komunën e Klinës.



Sipas vlerësimeve buxhetore të prezantuara në ligjin për buxhetin 2017¹⁶, buxheti i Klinës nuk do të ketë rritje të madhe më 2018 dhe 2019. Krahasuar më 2017, në këto dy vite të ardhshme buxheti planifikohet të jetë rreth dy përqind (8.9 milionë euro) dhe pesë përqind (9 milionë euro) më i lartë, respektivisht. Në këto dy vite vijuese, Klina planifikon ta rrisë buxhetin për afro 50% për investimet në infrastrukturë dhe bujqësi, dhe rritjen e kapaciteteve në administratë. Shumica e këtyre mjeteve planifikohet të vijnë nga reduktimi i shumës të ndarë për shëndetësi dhe mirëqenie.

Rekomandimet

Duke u bazuar në problemet kryesore, fushat të cilat kërkojnë vëmendjen e Komunës dhe trendet buxhetore, Instituti GAP rekomandon që qeverisja e komunës e dalë nga zgjedhjet lokale të 2017 të ndërmerret këto veprime:

- Komuna e Klinës duhet të ndajë buxhet për çdo vit për t'i mundësuar kërkimet arkeologjike në zonën e Dresnikut.
- Komuna e Klinës duhet t'i shohë gjetjet e deritanishme në Dresnik si potencial për zhvillimin e turizmit.
- Komuna e Klinës duhet t'i shpeshtojë inspektimet ndaj kompanive të gurthyeseve me qëllim të sigurohet se këto kompani po ndërmarrin masat e nevojshme për parandalimin e rreziqeve të ndryshme, veçmas shmangien e problemeve që dalin nga përhapja e pluhurit.
- Komuna e Klinës duhet të nisë zhvendosjen e gypave të vjetër të ujit nga qyteti me qëllim të shmangies se problemeve të supozuara shëndetësore nga ekzistimi i gypave të tillë.
- Komuna e Klinës duhet të shohë investimet me prioritet sa i përket furnizimit të qytetarëve me ujë të pijes.
- Komuna e Klinës duhet të ndërtojë terrene sportive veçmas në zonat urbane të qytetit.

¹⁶ Ligji Nr. 05/L-125 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2017, faqe 248.

INSTITUTI GAP
GAP INSTITUTE



Instituti GAP është think-tank i themeluar në tetor të 2007 në Kosovë. Qëllimi kryesor i GAP-it është të tërheq profesionistë për të krijuar një ambient të zhvillimit dhe hulumtimit profesional, që haset në institucione të ngjashme në shtetet perëndimore. Kjo gjithashtu u ofron mundësi kosovarëve për hulumtimin, zhvillimin dhe implementim e projekteve me qëllim të avancimit të shoqërisë kosovare. Prioritet për këtë Institut është mobilizimi i profesionistëve në adresimin e sfidave ekonomike, politike dhe sociale të vendit. Qëllimet kryesore të GAP-it janë të mbush zbrazëtitë në mes të qeverisë dhe qytetarëve, si dhe të mbushë zbrazëtitë në mes të problemeve dhe zgjidhjeve.

Ky projekt mbështetet nga:



**National Endowment
for Democracy**

Supporting freedom around the world